

Ngjitës për PVC

# UZIN KE 478

Ngjitës disperziv për shtruarjen e të gjitha llojeve të dyshemeve nga PVC-ja në ambiente të brendshme

## Fushat e aplikimit:

UZIN KE 478 është ngjitës disperziv për ngjitjen e të gjitha llojeve të dyshemesë nga PVC dhe CV, në rrolle dhe pllaka, dysheme tekstili në bazë të PVC, lateks apo shkumë poliuretani, lateks apo shkumë e butë e shtypur, dhe pllaka elastike në ambiente të brendshme. Poashtu përdoret thjeshtë si ngjitës i lagësht mbi të gjitha llojet e nënshtresave me thithshmëri adekuate dhe astarë (prajmer) në bazë uji.

## Vetitë dhe përparësitë:

UZIN KE 478 është ngjitës në bazë të disperzivit uxor me shtesë të rrëshirës artificiale i shkrië në proporcion minimal të tretësit organik, i cili plotëson kërkesat sipas GefStoffV / TRGS610 për shpërndarjen e mallrave të rrezikshme.

## Përparësitë:

- ▶ Erë neutrale
- ▶ Ekonomik (shpenzim i vogël)
- ▶ Spektër i gjërë përdorimi
- ▶ Koha e shkurtë e tharjes
- ▶ Lidhje e shpejtë
- ▶ Aderim i mirë fillestar
- ▶ Forcë e lartë dhe elasticitet



## Shenimet teknike:

|                            |                     |
|----------------------------|---------------------|
| Paketimi:                  | Kovë PVC 14kg       |
| Qëndrueshmëria:            | min. 12 muaj        |
| Ngjyra lagësht/thatë       | krem bardhë/i qartë |
| Pesha specifike:           | 1,27 kg/litër       |
| Temperatura e punës:       | + 18 °C deri +25 °C |
| Temperatura e nënshtresës: | min. +15 °C         |
| Shpenzimi:                 | 200 – 350 g/m2      |
| Koha e hapur:              | 0 – 10 minuta*      |
| Koha e punës:              | 40 – 60 minuta*     |
| Mund të shkilet:           | pas 1 – 2 ditësh *  |
| Forca finale               | pas 3 – 4 ditësh *  |

\* Në 20°C dhe 65% lagështi relative të ajrit.



### Përgatitja e nënshtresës:

Nënshtresa duhet të jetë e thatë, e fortë, pa çarje dhe substanca të cilat mund të ndikojnë negativisht në ngjitje. Të gjitha parregullsitë në nënshtresë duhet të sanohen.

Kontrollojeni nënshtresën në mënyrë të përshtatshme dhe evidentoni mangësitë eventuale.

Pluhurin dhe papastërtinë e imët largoni duke përdorur thithëset e përshtatshme. Nënshtresën lyeni me astar dhe nivelizojeni me masë rrafshuese (autonivelant). Verësisht nga nënshtresa, lloji i dyshemesë dhe dedikimi i saj zgjidheni astarin dhe masën rrafshuese nga programi UZIN.

Mbi nënshtresa të jothithshme dhe ato të ndijshme ndaj lagështisë shtroni masën adekuate për nivelizim në trashësi minimale 2 mm ndërsa mbi nënshtresa të drurit së paku 3 mm.

Dyshemetë e vjetra duhet të jenë të lidhura (ngjitura) mirë me nënshtresën dhe duhet pastruar nga materiet për pastrim apo mirëmbajtje, të cilat mund të ndikojnë negativisht në ngjitje të mirë.

### Të dhëna të rëndësishme:

- Koha e deponimit të mallit është së paku 12 muaj në vend të thatë dhe të ftohtë në temperaturë mbi +5°C. Ambalazhën e nisur mbyllet mirë dhe me kujdes dhe sa më parë përdoren atë. Para përdorimit ngjitësin vendoseni në temperaturë të dhomës.
- Kushtet optimale për punë janë në temperaturë nga +18°C deri +25°C dhe temperatura e nënshtresës mbi +15°C.. Temperatura e lartë dhe lagështia e ultë relative e ajrit shkurtojnë, deri sa temperatura e ultë dhe lagështia e lartë në ajër zgjasin kohën e tharjes dhe dobësojnë ngjitjen.
- Para instalimit dyshemeja duhet të ketë elasticitet të përshtatshëm, të jetë aklimatizuar në kushte në të cilat do të përdoret.
- Për pastrimin e njollave të freskëta të ngjitësit dhe veglave të punës përdoren ujë.
- Gjatë punës ju lutemi rrespektoni rregullat DIN 18365 „Shtruaria e dyshemeve“ dhe udhëzimet teknike për përdorimin e prodhimeve të UZIN-it.

### Udhëzime për punë:

- ❶ Para përdorimit, ngjitësin përzieni mirë dhe me lapatëzën e përshtatshme shpërndajeni në mënyrë të njëkrahshme.
- ❷ Shpërndani vetëm aq ngjitës sa mund të shtroni dysheme brenda kohës së punës të ngjitësit. Ngjitësin shpërndajeni në atë mënyrë që mbi tërë shpinën e dyshemesë të krijohet rrujta e përshtatshme e ngjitësit.
- ❸ Shtrijeni me kujdes dyshemenë, lehtë shtypeni mbi nënshtresë.
- ❹ Kyçjet dhe parrafshitë, pas një kohe të shkurtë, shtypni edhe njëherë dhe rrafshoni me rul me peshë përkatëse. Sipas nevojës procedurën përsëriteni.
- ❺ Kyçjet në dyshemetë e shtruara saldohen pas së paku 24 orësh, më së miri pas 2-3 ditësh.

### Mbrojtja gjatë punës dhe mbrojtja e ambientit:

Ngjitësi përmban një sasi shumë të vogël të tretësirë organik e cila nuk i tejkalon kufijtë e përcaktuar sipas masave VbF dhe sipas saj nuk ka nevojë për kurrfarë masa sigurie dhe shenja sipas rregullave normative.

Preferohet përdorimi i kremit mbrojtës për duar dhe ajrosja e lokalit të punës.

### Hudhja e mbeturinave:

Aty ku është e mundur, mbeturinat e prodhimit mblidhen dhe përdorni përsëri. Mbetjet e papërdorura të prodhimit mos i hudhni në kanalizim, rrjedha ujore apo deponi ilegale. Pritni deri sa të thahen, pastaj depononi në mënyrë ligjore. Ambalazhën e mbetur hudhni sipas rregullores në fuqi.

### Shpenzimi:

| Shpina                   | Dhëmbëzorët | Shpenzimi                 |
|--------------------------|-------------|---------------------------|
| E lëmuar, p.sh. PVC      | A1          | 250-300 gr/m <sup>2</sup> |
| Tekstil me shpinë shkume | A2          | 300-350 gr/m <sup>2</sup> |